

GJUHA SHQIPE

Siç kemi thënë se gjuha jonë është shqipja, e ne jemi shqiptar me kombësi, ndërsa populli ynë jeton në keto shtete: **Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbinë Juglindore, Greqinë Veriore dhe në diasporë.**

Gjuha standarde është gjuha e përbashkët e shqiptarëve në shkrim, lexim, në shkollë, libra e televizionit dhe e dokumenteve zyrtare dhe është gjuhë **indoevropiane.**

Gjuha amtare është gjuha që mësojmë nga lindja, është gjuha e prindërve dhe familjarëve tanë, ndërsa Morfologjia është degë e gramatikës që studion **fjalët.**

Si çdo gjuhë tjetër edhe shqipja ka dy dialekte, e ato janë: **gegërishtja dhe toskërishtja**

-Gegërishtja flitet në **Shqipërinë e Veriut dhe atë të Mesme, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore, në Kosovën Veriore dhe në Mal të Zi.** -
Toskërishtja flitet në **Shqipërinë e Jugut, në Çamëri dhe në diasporën shqiptare në Itali, Greqi, Bullgari e Ukrainë.**

Dallimet kryesore të dialekteve të shqipes janë në: **fonetikë, morfologji dhe leksik** (terma gjuhësorë të një gjuhe apo dialekti).

Ndryshimet në fonetikë:

gegërisht	toskërisht	gegërisht	toskërisht
nana	nëna	grue	grua
kanga	kënga	përrue	përrua
ambël	ëmbël	thuej	thuaj
asht	është	bana	bëra
rana	rëra	dimën	dimër
andrra	ëndrra	hyni	hyri
zani	zëri	fëmijëni	fëmijëri

Ndryshimet morfologjike (ndryshimet të shumësi të emrave):

nxanësa	nxënës	pusa	puse
molla	mollë	brina	brirë
shtëpija	shtëpi		

Ndryshimet në leksik:

tambël	qumësht	tlyn	gjalpë
çikë	vajzë	këndues	gjel

Morfologjia është degë e gramatikës që studion **fjalët.**

Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës	Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës
emri	ndajfolja
mbiemri	parafjala
përemri	lidhëza
folja	pjesëza
numërori	pasthirrma

Fjalët e ndryshueshme kanë kategorinë e gjinisë, të numrit, të rasës, të mënyrës, të kohës e të tjera.

Lloji i fjalëve	kategoria
emri	gjini, numër, shquarsi, rasë
mbiemri	gjini, numër, rasë, shkallë krahasimi
përemri	gjini, numër, rasë, vetë
folja	gjini, numër, vetë, mënyrë, kohë
numërori	gjini, rasë

Emri

Emri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, që emërton një frymor, një send, një cilësi, një veprim.

Sipas kuptimit emrat ndahen në: **emra të përveçëm** dhe **emra të përgjithshëm**.

Emra të përveçëm

Emra njerëzish dhe pseudonime	Bardhyl, Teutë, Dritë, Laurë, Gjin, etj
Emra kafshësh	Balosh, Murrojë, Bubi, Murro etj.
Emra vendesh	Shqipëri, Kosovë, Azi, Berlin, Prishtinë, Korab, Myzeqe, Shkumbin,
Emra të trupave qiellore	Dielli, Hëna, Jupiteri, Kashta e Kumtrit, Ylli Polar, Toka etj
Emra të ngjarjeve dhe periudhave historike	Rilindja Kombëtare, Kongresi i Manastirit, Luftërat e Skënderbeut, Lufta e UÇK-së etj.
Titujt e veprave letrare, gazetave, revistave, institucioneve etj.	„Lulet verës“, „Lahuta e Malcis“, „Lumi i vdekur etj.

Emra të përgjithshëm

qenie (njerëzore, shtazore dhe bimore)	vajzë, djalë, nënë, baba, nxënës, mësuese, punëtor, mjek, zog, shqiponjë, lule, etj.
objekte (sende)	shtëpi, libër, makinë, brushë, shkollë, çantë etj.
dukuri (natyrore)	yll, erë, shi, borë, frymë etj.

-Emrat janë **konkretë** dhe **abstraktë**. Ata konkretë shënojnë frymorë, sende dhe dukuri që mund të shihen ose të preken: vogëlush, shishe, laps, dele, ujë, fustan etj. Ndërsa emrat abstraktë nuk shihen dhe nuk preken: mendim, ndjenjë, trimëri, rrenë, pikëllim, butësi, gëzim etj.

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

Emrat e përgjithshëm shkruhen me shkronjë të vogël, përveçse atëherë kur shkruhen në fillim të fjalisë.

Emri në gjuhën shqipe ka dy numra: **numri njëjës** dhe **numri shumës**.

PLOTËSONE TABELEN E POSHTME

FJALËT E THJESHTA	FJALËT E PËRBËRA	EMRAT E PËRVEÇËM	EMRAT E PËRGJITHSHËM
Hunda			
Besë			
Krye			
Zemër			
Sy		EMRAT KONKRET	EMRAT ABSTRAKT
Vesh			
Flok			
Qafë			
Gjuhë			
Vetull			